



PAGESA PËR FËMIJËT



Ku duhet të bëj kërkesë për të përfituar pagesën për fëmijët deri në 6 vjeç?

Që të përfitoni pagesën për fëmijët, është e nevojshme që të paraqiteni në Qendrën për Punë Sociale në komunën në të cilën banon fëmija dhe prindi/kujdestari në emër të të cilit do të kryhet pagesa për fëmijët. Në bazë të ndryshimeve të Ligjit, mund të realizohet e drejta për të drejtë për pagesë për fëmijët maksimalisht deri për pesë fëmijë në një familje.

Çfarë dokumentesh duhet të kem me vete? A duhet që të plotësoj ndonjë kërkesë?

Është e nevojshme që në Qendër të identifikoheni me letërnjoftim dhe punonjësit social që bën pritjen ti jepni numrat personalë të qytetarëve të anëtarëve të familjes tuaj dhe gjithçka në vijim kryhet automatikisht nëpërmjet e-Kartelës Sociale.

Kur duhet të bëj kërkesë në Qendrën për Punë Sociale?

Paraqitja e kërkesave fillojnë nga 1 Shtatori. Mund të paraqiteni në ditët e punës (nga e Hëna deri të Premten) në periudhën kohore nga ora 7 deri në orën 18 dhe të shtunën nga ora 7 deri në orën 12. Në rast se dëshironi që të përfitoni të drejtën e pagesës për fëmijë duke filluar nga Tetori (kur në bazë të Ligjit fillon zbatimi i saj) është e nevojshme që të paraqisni kërkesë në Qendër në periudhën nga 1 deri në 30 Shtator 2021. Në mënyrë që të mos krijohen grumbullime të panevojshme njerëzish, do të afishojmë në fund të Gushtit një radhë për paraqitje kërkesash (në bazë të shkronjës parë të mbiemrit të fëmijës).

Kur do të kryhet pagesa për fëmijët dhe si do të bëhet?

Pagesa për fëmijët do të paguhet në mes të Nëntorit për muajin Tetor, në rast se kërkesën e kenë paraqitur në Shtator. Pagimi i ndihmës materiale, dhe me këtë edhe i pagesës për fëmijët, do të kryhet gjithmonë në mes të muajit vijues për muajin e mëparshëm. Pagesa kryhet nëpërmjet Postës së Malit të Zi, në adresën e banimit që do ti deklaroni punonjësit social me rastin e paraqitjes së kërkesës për pagesën për fëmijët në Qendrën për Punë Sociale.

Në qoftë se kërkesën e paraqis në Tetor e jo në Shtator, a do të thotë kjo që në Tetor nuk do të përfitoj pagesën për fëmijët?

Në rast se nuk e paraqisni kërkesën në Shtator, nuk do ta përfitoni pagesën për fëmijët për muajin Tetor. Zbatimi i ndryshimit të Ligjit që lidhet me pagesën për fëmijët nga 0 deri në 6 vjeç fillon në Tetor 2021, dhe në bazë të kësaj edhe pagesa e parë (për ata që kanë paraqitur kërkesë në Shtator) lidhet me muajin Tetor dhe do të paguhet në mes të Nëntorit.

Jemi të divorcuar, dhe fëmija më është besuar mua në kujdestari. A do të kryhet pagesa për fëmijët në emrin tim?

Në rastin që prindërit janë të divorcuar, dhe fëmija i është besuar njërit nga prindërit, pagesa për fëmijët do të paguhet në emrin e atij prindi. Prandaj është e nevojshme që, me rastin e paraqitjes së kërkesës në Qendër, prindi të sjellë dëshminë (vendimin e organit kompetent) që fëmija i është besuar atij në kujdestari, dhe kuptohet që adresa e banimit të prindit dhe e fëmijës duhet të jetë e njëjtë.

Adresa ime e banimit të përhershëm është në Nikshiq, por e fëmijës është në Podgoricë ku punojmë dhe jetojmë. A duhet që të ndryshoj adresën e përhershme në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MBP)?

Në rast se adresa e përhershme e prindit dhe e prindit janë të ndryshme, Ju këshillojmë që ta ndryshoni adresën e banimit të përhershëm para Shtatorit. Adresa e banimit të prindit, në emër të të cilit do të paguhet pagesa për fëmijët, dhe e fëmijës duhet të jetë e njëjtë.

Fëmija im mbush në Tetor 2021 6 vjeç. A do të përfitoj pagesë për fëmijë?

Në rast se fëmija mbush 6 vjeç në Tetor, do ta përfitojë pagesën për fëmijë, në rast se paraqisni kërkesë në Shtator. Ju do të përfitoni pagesë për fëmijët vetëm për një muaj (30 euro).

Kam dy djem binjakë me moshë 18 muaj dhe një vajzë 4 vjeçe. A kanë të tre këta fëmijë të drejtë për pagesë për fëmijët?

Po, që të tre fëmijët kanë të drejtë për pagesë për fëmijët.

A duhet të shkoj në Qendrën për Punë Sociale dhe tu them se fëmija më ka mbushur 6 vjeç dhe të ndërpresin pagimin e pagesës për fëmijët?

Ndalimi i pagimit të pagesës për fëmijët është i automatizuar, kështu që nuk është e nevojshme që të shkoni në Qendrën për Punë Sociale kur fëmija Juaj mbush moshën 6 vjeç, që të ndalohej pagimi i mëtejshëm.

Për prindërit/kujdestarët e fëmijëve që janë shfrytëzues të ndihmave materiale (shfrytëzuesit e pagesës për fëmijët në bazë të: sigurisë materiale, shtesave për kujdesje dhe ndihmë, pagesë për invaliditet personal, për fëmijë pa kujdes prindëror, për fëmijët e prindërve që janë në procesin e aktivizimit për punësim):

AA duhet që të paraqitem në Qendër për të përfituar shtesë në emër të pagesës për fëmijë?

Për të përfituar shtesë të pagesës për fëmijë, nuk duhet që të bëni kërkesë në Qendër. Nëpërmjet e-Kartelës Sociale, shumica e pagesës për fëmijët do të shtohet automatikisht dhe do të paguhet duke filluar që nga përllogaritja për Tetorin, dhe çekut të Nëntorit do ti shtohet pagesa për fëmijët (44 euro për çdo fëmijë). Ky ndryshim do të kryhet automatikisht nëpërmjet e-Kartelës Sociale, dhe pagesa për fëmijë e shtuar do të paguhet duke filluar që nga përllogaritja e Tetorit.

Jemi shfrytëzues të sigurisë sociale dhe tre fëmijë marrin pagesë për fëmijët. A ka fëmija i katërt, që është tre vjeç, të drejtë për pagesë për fëmijët? A duhet që të shkoj në Qendër për të kryer paraqitjen e tij?

Fëmija i katërt ka të drejtë për pagesë për fëmijët. Nuk është e nevojshme që të vini në Qendër për të kërkuar pagesë për fëmijën e katërt. Ky fëmijë (nëpërmjet e-Kartelës Sociale) do ta përfitojë automatikisht pagesën dhe ajo do t'u paguhet në Nëntor së bashku me pagesat e tjera.

Tani tre fëmijët e mi, me bazën e sigurisë sociale do të marrin nga 44 eura secili. Fëmija e katërt do të marrë 30 euro apo 44 euro?

Të katër fëmijët do të marrin në muaj nga 44 euro secili. Domethënë, për të katër fëmijët do të merrni shumën gjithsej prej 176 eura në bazë të pagesës për fëmijët. Në bazë të ndryshimeve të Ligjit, deri në pesë fëmijë në një familje mund të realizojnë të drejtën për pagesë për fëmijët.

A do të marrë fëmija im pagesë të shtuar për fëmijët, në rast se unë kam realizuar fillimisht të drejtën për shtesë për kujdesin dhe ndihmën ose për pagesë personale për invaliditet?

Në rastin që përmendët, shfrytëzues i të drejtës për shtesë për kujdes dhe ndihmë ose për pagesë për invaliditet jeni Ju, e jo fëmija, pra fëmija nuk do të marrë shtesën për pagesën e fëmijëve. Shtesa lidhet me fëmijët të cilët janë shfrytëzues të të drejtës për shtesë për kujdes dhe ndihmë ose për pagesë personale për invaliditet.

